



**SHËRBIMI I EMIGRACIONIT DHE NATYRALIZIMIT TË
IRLANDËS**

ZYRA E MBROJTJES NDËRKOMBËTARE

**Broshurë informative për aplikantë
për mbrojtje ndërkombëtare**

**LUTEMI, LEXONI TË GJITHË INFORMACIONIN E KËSAJ BROSHURE PARA
SE TË FILLONI ME PLOTËSIMIN E PYETËSORIT PËR MBROJTJEN TUAJ
NDËRKOMBËTARE**

Qëllimi i kësaj broshure

Kjo broshurë informative do t'ju ndihmojë të kuptoni procedurat për përpunimin e aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare në Irlandë. Ajo do t'ju shpjegojë cilat janë të drejtat dhe detyrimet dhe kë do të merrni me vete gjatë aplikimit, shqyrtimit dhe procesit të rekomandimit/përcaktimit. Kjo broshurë gjithashtu siguron informacion në lidhje me dhënien e lejes për qëndrim për arsye të tjera.

Shënime të rëndësishme

Ju duhet ta mbani këtë broshurë informative në mënyrë që të mund t'i referoheni përsëri asaj, ndërsa aplikimi juaj është duke u përpunuar.

Kur bëni aplikimin tuaj për mbrojtje ndërkombëtare, ju hyni në një procedurë ligjore. Dokumentet që ju duhen për të plotësuar dhe informacionet që ju duhen për të siguruar si pjesë e procesit të aplikimit, shqyrtimit dhe rekomandimit/përcaktimit janë thelbësore për këtë proces. Për rrjedhojë, është shumë e rëndësishme të lexoni, plotësisht, informacionin e mëposhtëm dhe të kërkonti këshilla ligjore, siç kërkohet, në mënyrë që të jeni në një pozicion për ta mbështetur aplikimin tuaj. Ju duhet të bashkëpunoni me Zyrën e Mbrojtjes Ndërkombëtare (IPO). Mosveprimi në këtë mënyrë mund të ketë pasoja të dëmshme ligjore për rezultatin e aplikimit tuaj.

Ligji që rregullon shqyrtimin dhe përcaktimin e kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare, si dhe lejen për të qëndruar dhe bashkimin familjar në Irlandë është përcaktuar në Aktin e Mbrojtjes Ndërkombëtare 2015 (Akti i 2015) dhe në urdhrat dhe rregulloret e bëra sipas këtij Akti. Ju mund të keni akses të plotë të këtij legjislacioni në faqet e mëposhtme të internetit www.inis.gov.ie dhe www.ipo.gov.ie.

Kjo broshurë është vetëm për qëllime informacioni dhe udhëzimi. Kjo broshurë nuk është këshillë ligjore dhe nuk jep një interpretim ligjor të Aktit të Mbrojtjes Ndërkombëtare 2015. Nëse keni nevojë për më shumë informacione në lidhje me Aktin e 2015 dhe ndikimin e tij në rastin tuaj, duhet të merrni këshilla ligjore.

Ndërsa çdo përpjekje është bërë për të siguruar që përmbajtja e kësaj broshure të jetë e saktë, nuk pranohet asnjë përgjegjësi për ndonjë gabim ose mungesë në të. Për më tepër, asgjë në këtë broshurë nuk do të merret si një përfaqësim a premtim që mund të bëhet shkak për ndonjë detyrim ligjor nga ana e Ministrit për Drejtësi dhe Barazi ("Ministri") ose ndonjë pale tjetër, duke përfshirë edhe oficerë dhe stafin e Zyrës për Mbrojtjen Ndërkombëtare, përtej çdo detyrimi të krijuar me ligj.

Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare
Shërbimi i Emigracionit dhe Natyralizimit të Irlandës

Janar 2017

Përmbajtja

Seksioni 1 Çfarë është mbrojtja ndërkombëtare dhe si të aplikohet për të?

- 1.1 Çfarë është mbrojtja ndërkombëtare?
- 1.2 Kush mund të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare?
- 1.3 A është bërja e një aplikimi për mbrojtje ndërkombëtare rruga e drejtë e veprimit në rrethanat e mia?
- 1.4 Ku duhet ta bëj aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare?
- 1.5 Kush do ta trajtojë aplikimin tim për mbrojtje ndërkombëtare?
- 1.6 Çfarë është leja e qëndrimit dhe si të aplikohet për të?
- 1.7 Çfarë është bashkimi familjar?

Seksioni 2 Terma të dobishme

- 2.1 Çfarë është Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare (IPO)?
- 2.2 Çfarë është Gjykata e Apelit për Mbrojtje Ndërkombëtare (IPAT)?
- 2.3 Kush është Ministri?
- 2.4 Kush konsiderohet refugjat?
- 2.5 Kush konsiderohet i pranueshëm për mbrojtje ndërkombëtare?
- 2.6 Çfarë është lëndimi i rëndë?
- 2.7 Çfarë është ndalimi i dëbimit?
- 2.8 Kush përjashtohet nga mbrojtja ndërkombëtare?
- 2.9 Çfarë është EURODAC?
- 2.10 Cila është fusha e veprimit e Zonës së Përbashkët të Udhëtimit?

Seksioni 3 Procesi i mbrojtjes ndërkombëtare

- 3.1 Çfarë mund të pres kur bëj aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare?
- 3.2 Cilat janë hapat e para në procesin e aplikimit?
- 3.3 Si do të përcaktohet pranueshmëria e aplikimit tim?
- 3.4 Nëse unë kam marrë tashmë një vendim për një kërkesë të mëparshme për mbrojtje ndërkombëtare, a mund të bëj një tjetër aplikim (aplikimi vijues)?
- 3.5 Çfarë është intervista paraprake?
- 3.6 A do të më merren gjurmët e gishtërinjve dhe informacione të tjera biometrike?
- 3.7 A do të marrë informacione më shkrim në lidhje me procesin e mbrojtjes ndërkombëtare?
- 3.8 Çfarë më nevojitet të kem me vete kur bëj aplikimin tim për mbrojtje ndërkombëtare?
- 3.9 Çfarë është Certifikata e Rezidencës së Përkohshme (TRC) dhe kur e marr atë?
- 3.10 Çfarë ndodh nëse jam person me aftësi të kufizuar ose kam nevoja të posaçme?
- 3.11 A mund të aplikoj për mbrojtje ndërkombëtare nëse jam në arrest ose në paraburgim?
- 3.12 Në cilat rrethana mund të arrestohet një aplikant për mbrojtje ndërkombëtare?
- 3.13 Çfarë ndodh nëse kam nën ngarkim persona nën 18 vjeç?
- 3.14 Ku mund të marr këshillë ligjore?
- 3.15 A mund ta tërheq aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare?

Seksioni 4 Intervista dhe shqyrtimi

- 4.1 Çfarë mund të pres nga intervista për mbrojtjes ndërkombëtare?
- 4.2 A mund të sjell me vete dikë që të më mbështesë në intervistën për mbrojtje ndërkombëtare?
- 4.3 Çfarë ndodh nëse nuk mund të paraqitem në intervistë ose nuk paraqitem në intervistë?
- 4.4 A e kam për detyrë të bashkëpunoj me procesin e aplikimit dhe cilat janë pasojat nëse nuk e bëj këtë?
- 4.5 Çfarë është procesi i shqyrtimit kryesor, përfshirë intervistën time personale?
- 4.6 Çfarë ndodh pas intervistës sime?
- 4.7 Cilat janë rezultatet e mundshme të aplikimit tim për mbrojtje ndërkombëtare?
- 4.8 Çfarë ndodh nëse, brenda 6 muajve, nuk marr një rekomandim në lidhje me aplikimin tim për mbrojtje ndërkombëtare

Seksioni 5 Apeli dhe mbrojtja ndërkombëtare

- 5.1 A kam të drejtë të apeloj një rekomandim për të mos marrë mbrojtje ndërkombëtare dhe rekomandime të tjera?
- 5.2 Si mund të apeloj?
- 5.3 Cilat janë afatet e depozitimit të apelit?
- 5.4 A kam të drejtë përfaqësimi ligjor për apelin tim?
- 5.5 Sa kohë duhet që të shqyrtohet apeli im?
- 5.6 Ku mund të gjej më shumë informacione rreth procesit të apelit?

Seksioni 6 Deklarimi i statusit të refugjatit ose mbrojtjes së përkohshme

- 6.1 Çfarë ndodh pas marrjes së rekomandimit?

Seksioni 7 Të drejtat tuaja nëse u jepet mbrojtje ndërkombëtare

- 7.1 Cilat janë të drejtat e mia nëse marr mbrojtje ndërkombëtare?

Seksioni 8 Të drejtat dhe detyrimet tuaja në procesin e mbrojtjes ndërkombëtare

- 8.1 Cilat janë të drejtat e mia në procesin e aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare?
- 8.2 Cilat janë detyrimet e mia në procesin e aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare?

Seksioni 9 Fëmijët e pashoqëruar

- 9.1 Çfarë ndodh nëse kërkoj të aplikoj për mbrojtje ndërkombëtare si fëmijë i pashoqëruar?
- 9.2 Cila është procedura nëse TUSLA - Agjencia për Fëmijët dhe Familjen bën një aplikim për mua për mbrojtje ndërkombëtare?

9.3 *Cila është procedura për ta referuar një fëmijë nën 18 vjeç tek Bordi i Ndhmës Ligjore (LAB)?*

Seksioni 10 Rregullorja e Dublinit (BE)

10.1 *Çfarë është Rregullorja e Dublinit (BE)?*

Seksioni 11 Opsionet e kthimit vullnetar

11.1 *A gëzoj opsionin e kthimit vullnetar në vendin tim të origjinës/vendin e ish rezidencës së zakonshme?*

Seksioni 12 Informacione të tjera

12.1 *Cilat janë procedurat e prioritizimit të aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare?*

12.2 *Çfarë do t'i ndodhë informacionit që i jap Zyrës së Mbrojtjes Ndërkombëtare?*

Seksioni 13 Leja e qëndrimit

13.1 *Si të aplikoj për lejen e qëndrimit?*

13.2 *Cilat janë informacionet relevante për vendimin e Ministrit për dhënien ose refuzimin e lejes së qëndrimit në shtet (Irlandë)?*

13.3 *Çfarë ndodh nëse më refuzohet leja e qëndrimit?*

13.4 *Çfarë ndodh nëse më jepet leja e qëndrimit?*

13.5 *Si funksionon "rishikimi" i refuzimit të lejes së qëndrimit?*

13.6 *Çfarë ndodh nëse më jepet leja e qëndrimit, por vendos të apeloj te IPAT-i rekomandimin e mbrojtjes nga IPO-ja?*

13.7 *Çfarë ndodh nëse më refuzohet leja e qëndrimit pas procesit të rishikimit?*

Seksioni 14 Bashkimi familjar

14.1 *Çfarë është bashkimi familjar?*

14.2 *A ka një afat?*

14.3 *Çfarë është një pjesëtar familje?*

14.4 *Cilat informacione duhet të përfshij në pyetëSORIN dhe formularin e aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare?*

14.5 *Si mund të aplikoj për bashkim familjar?*

Seksioni 15 Akomodimi juaj

15.1 *Informacionet e pranimit/akomodimit*

Shtojca - Të dhënat e kontaktit

Seksioni 1

Çfarë është mbrojtja ndërkombëtare dhe si të aplikohet për të?

1.1 Çfarë është mbrojtja ndërkombëtare?

1.1.1 Ka dy forma të mbrojtjes ndërkombëtare të mbuluara nga Akti i Mbrojtjes Ndërkombëtare 2015, përkatësisht statusi i refugjatit dhe mbrojtja e përkohshme.

Statuti i refugjatit

1.1.2 Për t'u njohur si *refugjat*, duhet të jesh një person që ke një frike të bazuar mirë se po përndiqesh për arsye të:

- (i) racës,
- (ii) fesë,
- (iii) kombësisë,
- (iv) opinionit politik ose
- (v) anëtarësimin në një grup të veçantë social,

është jashtë vendit të tij ose të saj të shtetësisë dhe nuk është në gjendje ose, për shkak të një frike të tillë, nuk është i gatshëm të përfitojë nga mbrojtja e atij vendi, ose një person pa shtetësi, i cili, duke qenë jashtë vendit të tij ose saj të mëparshëm të banimit të përhershëm për të njëjtën arsye siç u përmend më sipër, nuk është në gjendje ose për shkak të frikës së tillë, nuk është i gatshëm për t'u kthyer në atë vend.

Statusi i mbrojtjes së përkohshme

1.1.3 Nëse vendoset se nuk jeni një refugjat, mund të kualifikoheni për *mbrojtje të përkohshme nëse ka arsye serioze për të besuar se ju do të përballeni me një rrezik real që do të vuani dëme serioze nëse ktheheni në vendin tuaj të origjinës/vendit të mëparshëm të banimit të përhershëm*. Shih **seksionin 2.5.1** për më shumë informacione.

1.2 Kush mund të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare?

1.2.1 Një person i cili është 18 vjeç e lart dhe që është në kufi të Shtetit (Irlandës) ose kur është në këtë Shtet (Irlandë) mund të bëjë një aplikim për mbrojtje ndërkombëtare

- (a) në emër të tij ose saj
- (b) në emër të një personi, i cili është nën moshën 18 vjeç dhe për kujdesin dhe mbrojtjen e të cilit ai ose ajo mban përgjegjësi.

1.2.2 Kjo i nënshtrohet aplikimit të përmendur në **paragrafin 1.2.1**

- (a) nëse konstatohet i pranueshëm (**shih paragrafin 3.3**), ose

- (b) nëse ka një aplikim të mëvonshëm, i pranuar me pëlqim të Ministrit (shih **seksionin 3.4**).

Shih, gjithashtu, **seksionin 3.13** në lidhje me fëmijët nën varësi.

1.3 A është bërja e një aplikimi për mbrojtje ndërkombëtare rruga e drejtë e veprimit në rrethanat e mia?

- 1.3.1 Ju duhet të aplikoni për mbrojtje ndërkombëtare vetëm nëse keni frikë të ktheheni në vendin tuaj të origjinës/vendit të mëparshëm të banimit të përhershëm/kombësisë.
- 1.3.2 Nëse ka arsye të tjera që kërkon për të qëndruar në shtet (Irlandë), lutemi, referojuni faqes së internetit www.inis.gov.ie për informacione.

1.4 Ku duhet ta bëj aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare?

- 1.4.1 Aplikimin duhet ta bëni **personalisht** para Ministrit. Ju duhet ta bëni këtë sa më shpejt të jetë e mundur, në aeroport apo port detar ku keni arritur në Irlandë ose (pas hyrjes në shtet), pranë

**International Protection Office,
Irish Naturalisation and Immigration Service
79-83 Lower Mount Street,
Dublin 2.
D02 ND99**

1.5 Kush do ta trajtojë aplikimin tim për mbrojtje ndërkombëtare?

- 1.5.1 Duke aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare, jeni duke kërkuar që Ministri të shqyrtojë nëse kualifikoheni për një deklaratë refugjati *ose* deklaratë për mbrojtje të përkohshme.
- 1.5.2 Si pjesë e një procedure të vetme aplikimi, aplikimi juaj për mbrojtje ndërkombëtare normalisht do të shqyrtohet nga oficerët, të njohur si oficerët e mbrojtjes ndërkombëtare pranë Zyrës për Mbrojtje Ndërkombëtare. Kjo është pjesë e Shërbimit të Natyralizimit dhe Emigracionit të Irlandës, i cili nga ana e tij përfshihet brenda Departamentit të Drejtësisë dhe të Barazisë. Gjithashtu, edhe persona të tjerë brenda IPO-së mund të përfshihen në proces.

1.6 Çfarë është leja e qëndrimit dhe si të aplikohet për të?

- 1.6.1 Nëse IPO-ja rekomandon që nuk keni të drejtë për statusin e refugjatit ose të mbrojtjes së përkohshme, Ministri do të marrë parasysh nëse duhet t'ju japë ose jo leje për të qëndruar në Shtet (Irlandë) për një arsye tjetër (për shembull, për shkak të familjes suaj apo rrethanave personale). Ky funksion do të kryhet, gjithashtu, në Zyrën Ndërkombëtare të Mbrojtjes. Ju duhet të paraqisni informacionin përkatës në pjesën e duhur të pyetësorit të mbrojtjes ndërkombëtare. Ju duhet, gjithashtu, të

informoni IPO-në për çdo ndryshim të rrethanave tuaja, të cilat mund të jenë të rëndësishme për vendimin, për miratimin ,ose refuzimin e lejes suaj për të qëndruar.

Kjo trajtohet në mënyrë më të hollësishme në **seksionin 13**.

1.7 Çfarë është bashkimi familjar?

- 1.7.1 Nëse ju jepet statusi i refugjatit ose i mbrojtjes së përkohshme, mund të aplikoni te Ministri, brenda një periudhe prej një viti nga data e dhënies, për t'ju dhënë leje për disa anëtarë të familjes suaj që të hyjnë dhe banojnë në Shtet (Irlandë). **Kjo ka të bëjë vetëm me bashkëshortët, partnerët civilë (nëse ishit të martuar ose në një partneritet civil me atë person në datën e aplikimit tuaj të mbrojtjes), fëmijët e pamartuar nën 18 vjeç dhe, në rastin e një të mituri që i është dhënë mbrojtje, prindërit dhe vëllezërit e motrat e aplikantëve që janë nën moshën 18 vjeç.**
- 1.7.2 Ministri do të hetojë kërkesën dhe, nëse bindet se personi është një anëtar i familjes suaj që mbulohet nga kërkesa e ribashkimit të familjes, do t'i japë atij personi një leje qëndrimi.
- 1.7.3 Ministri mund të refuzojë të japë leje për një anëtar të familjes për një numër arsyesh, përfshirë në interes të sigurisë publike, politikave publike ose të rendit publik, ose kur një anëtar i tillë i familjes do të ishte, apo është, përjashtuar nga të qenit refugjat apo person me të drejtë për mbrojtje të përkohshme.
- 1.7.4 Është e rëndësishme të theksohet se kur bëni një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare ju duhet të siguroni të gjitha detajet e anëtarëve të familjes të cilët mund të kualifikohen më pas për bashkim familjar dhe një deklaratë e refugjatit ose statusi i mbrojtjes plotësuese duhet t'ju jepet nga Ministri.
- 1.7.5 Për më shumë informacione, shih **seksionin 14**.

Seksioni 2 Terma të dobishme

2.1 Çfarë është Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare (IPO)?

2.1.1 IPO-ja është një zyrë brenda Shërbimit të Natyralizimit dhe Emigracionit të Irlandës (INIS), përgjegjëse për shqyrtimin dhe përpunimin e kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare. Kreu i IPO-së është Kryeoficeri i Mbrojtjes Ndërkombëtare, i cili drejton një ekip oficerësh për mbrojtje ndërkombëtare. Stafit i IPO-së do të vendosë, në emër të Ministrit, nëse duhet dhënë apo jo një leje për të qëndruar në Shtet (Irlandë) për arsye të tjera për aplikantët e pasuksesshëm për mbrojtje ndërkombëtare.

2.2 Çfarë është Gjykata e Apelit për Mbrojtje Ndërkombëtare (IPAT)?

2.2.1 IPAT-i është një organ ligjor i pavarur i themeluar për të vendosur mbi apelet e mbrojtjes ndërkombëtare dhe funksione të tjera apelimi që i janë dhënë nga Akti i Mbrojtjes Ndërkombëtare 2015 dhe legjislacioni tjetër përkatës.

2.3 Kush është Ministri?

2.3.1 Ministri është Ministri i Drejtësisë dhe Barazisë.

2.4 Kush konsiderohet refugjat?

2.4.1 Për t'u njohur si *refugjat*, duhet të jesh një person që ke një frike të bazuar mirë se po përndiqesh për arsye të:

- (i) racës,
- (ii) fesë,
- (iii) kombësisë,
- (iv) opinionit politik ose
- (v) anëtarësimin në një grup të veçantë social,

është jashtë vendit të tij ose të saj të shtetësisë dhe nuk është në gjendje ose, për shkak të një frike të tillë, nuk është i gatshëm të përfitojë nga mbrojtja e atij vendi, ose një person pa shtetësi, i cili, duke qenë jashtë vendit të tij ose saj të mëparshëm të banimit të përhershëm për të njëjtën arsye siç u përmend më sipër, nuk është në gjendje ose për shkak të frikës së tillë, nuk është i gatshëm për t'u kthyer në atë vend.

Ka disa kategori të personave të cilët janë të përjashtuar nga dhënia e statusit të refugjatit (**shih seksioni 2.8**).

2.5 Kush është i pranueshëm për mbrojtje të përkohshme?

2.5.1 Ky është një status që është i ngjashëm me atë të refugjatit. Ky status jepet nëse një person nuk kualifikohet si refugjat, por IPO-ja konsideron se personi që perballlet me rrezikun e lëndimit serioz në vendin e tij apo saj të origjinës.

Përkufizimi i saktë është se një *person i pranueshëm për mbrojtje të përkohshme* është një person

- (i) që nuk është shtetas i një shteti anëtar të Bashkimit Evropian,
- (ii) që nuk klasifikohet si refugjat,
- (iii) ndaj të cilit janë treguar baza substanciale për të besuar se ai ose ajo, nëse kthehet në vendin e tij të origjinës/vendit të mëparshëm të banimit të përhershëm, do të perballlet me një rrezik real për të pësuar lëndim të rëndë dhe që nuk është në gjendje, ose, për shkak të një rreziku të tillë, nuk është i gatshëm të shfrytëzojë mbrojtjen e atij vendi; dhe
- (iv) i cili nuk është përjashtuar nga e drejta për mbrojtje të përkohshme për arsye të caktuara. Lutemi, shih paragrafin **2.8.2**.

2.6 Çfarë është lëndimi i rëndë?

2.6.1 *Lëndimi i rëndë* është:

- (i) dënim me vdekje ose ekzekutim,
- (ii) tortura ose trajtimi çnjerëzor ose poshtëruës apo dënimi i një personi në vendin e tij të origjinës/vendit të mëparshëm të banimit të përhershëm, ose
- (iii) kërcënimi serioz dhe individual për jetën e një civili apo personi për shkak të dhunës së verbër në një situatë konflikti të armatosur ndërkombëtare ose të brendshme.

2.7 Çfarë është ndalimi i dëbimit?

2.7.1 Ndalimi i dëbimit do të thotë se Ministri nuk dëbon ose kthen një person në kufirin e një territori ku, sipas mendimit të Ministrit,

- (i) jeta ose liria e personit do të jetë e kërcënuar për arsye të racës, fesë, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, ose
- (ii) ekziston rreziku serioz që personi do t'i nënshtrohej dënimit me vdekje, torturës apo trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose poshtëruës.

Ministri duhet të veprojë në përputhje me këtë detyrë, pavarësisht nëse personit i është dhënë statusi i refugjatit ose të mbrojtjes së përkohshme.

2.8 Kush përjashtohet nga mbrojtja ndërkombëtare?

2.8.1 Një person përjashtohet nga njohja si refugjat nëse:

- (i) ai ose ajo është duke marrë mbrojtje ose ndihmë nga organe ose agjenci të Kombeve të Bashkuara (përveç Komisionerit të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR)), të tilla si Agjencia e Ndihmës dhe Punëve të Kombeve të Bashkuara (UNRWA) dhe se kjo mbrojtje ose ndihmë nuk ka pushuar.
- (ii) ai ose ajo është njohur nga autoritetet kompetente të vendit, në të cilin ai ose ajo ka marrë rezidencën, që ka të drejtat dhe detyrimet që lidhen me marrjen e shtetësisë së atij vendi, apo të drejta dhe detyrime të barasvlershme me to, ose
- (iii) ka arsye serioze për të konsideruar se ai ose ajo:
 - a. ka kryer një krim kundër paqes, krim lufte ose një krim kundër njerëzimit, siç përcaktohet në instrumentet ndërkombëtare të hartuara për të marrë masa në lidhje me këto krime,
 - b. ka kryer një krim të rëndë jopolitik jashtë Shtetit (Irlandës) para ardhjes së tij në Shtet (Irlandë), ose
 - c. është shpallur fajtor për vepra në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara.

Lutemi, vini re se ky përjashtim vlen edhe kur ka arsye serioze për të konsideruar se një person ka nxitur ose ka marrë pjesë ndryshe në kryerjen e një krimi ose vepre të përmendur në (iii).

2.8.2 Një person përjashtohet nga e drejta për mbrojtje të përkohshme nëse ekzistojnë arsye serioze për të konsideruar se ai ose ajo:

- (i) ka kryer një krim kundër paqes, krim lufte ose një krim kundër njerëzimit, siç përcaktohet në instrumentet ndërkombëtare të hartuara për të marrë masa në lidhje me këto krime,
- (ii) ka kryer një krim të rëndë,
- (iii) është shpallur fajtor për vepra në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara, ose
- (iv) përbën rrezik për komunitetin ose për sigurinë e shtetit (Irlandës).

Lutemi, vini re se ky përjashtim vlen edhe kur ka arsye serioze për të konsideruar se një person ka nxitur ose ka marrë pjesë ndryshe në kryerjen e një krimi ose vepre të përmendur në (i) – (iv).

- 2.8.3 Një person përjashtohet nga e drejta për mbrojtje të përkohshme, nëse ai ose ajo, para ardhjes së tij/saj në shtet (Irlandë), ka kryer një krim që nuk përmendet në **paragrafin 2.8.2** e cili, nëse kryhet në shtet (Irlandë), do të dënohej me burgim dhe nëse ai ose ajo është larguar nga vendi i tij ose e saj i origjinës/vendit të mëparshëm të banimit të përhershëm vetëm për të shmangur sanksionet që rezultojnë nga ai krim.

2.9 Çfarë është EURODAC?

EURODAC është një sistem elektronik për shkëmbimin dhe krahasimin e shenjave të gishtërinjve ndërmjet shteteve kontraktuese për zbatimin efektiv të Rregullores së Dublinit (BE). Shih **seksionin 10** për informacione në lidhje me Rregulloren e Dublinit (BE).

2.10 Cila është fusha e veprimit e Zonës së Përbashkët të Udhëtimit?

- 2.10.1 Zona e Përbashkët e Udhëtimit (CTA) përfshin Irlandën, Mbretërinë e Bashkuar, Ishujt e Kanalit dhe Ishullin e Manit.

Seksioni 3

Procesi i mbrojtjes ndërkombëtare

3.1 Çfarë mund të pres kur bëj aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare?

3.1.1 Kur aplikoni për mbrojtje ndërkombëtare, mund të prisni që:

- (i) Ju do të trajtoheni me respekt, dinjitet dhe drejtësi, pavarësisht moshës, aftësisë së kufizuar, kombësisë, përkatësisë etnike, racës, gjinisë, orientimit seksual, fesë apo besimit tuaj.
- (ii) IPO-ja pranon se ky proces mund të jetë i panjohur për ju dhe se mund të keni kaluar përvoja traumatike dhe se mund ta keni të vështirë për të zbuluar informacione të ndjeshme në lidhje me veten.
- (iii) Në mënyrë që rrethanat individuale të merren plotësisht në konsideratë gjatë shqyrtimit të aplikimit tuaj, IPO-ja dëshiron të ndjeheni të sigurt në ndarjen e ndonjë informacioni të ndjeshëm, për shembull, në lidhje me përdhunimin, torturën, keqtrajtimin, apo seksualitetin tuaj, aty ku është relevante për aplikimin juaj. Të gjitha detajet e dhëna në lidhje me aplikimin tuaj do të trajtohen me konfidencialitet, në përputhje me ligjin dhe nuk do t'u zbulohet autoriteteve të vendin tuaj ose përfaqësuesve të vendit tuaj në Irlandë.
- (iv) Nëse keni ndonjë përvojë të veçantë, vendosuni në pozicion të tillë që ta keni më të lehtë për të biseduar me një burrë apo një grua në lidhje me përvojat tuaja, IPO-ja do t'u përgjigjet kërkesave të tilla, ku është e mundur.
- (v) Ju do të pyeteni nëse jeni në gjendje të flisni me IPO-në në anglisht ose në qoftë se do t'ju duhet një përkthyes/interpret. Ju keni të drejtë, kur është e nevojshme dhe e mundur, për të pasur një përkthyes për të siguruar komunikimin e duhur.

3.2 Cilat janë hapat e para në procesin e aplikimit?

3.2.1 Është e rëndësishme të theksohet se, para se mund të bëni një aplikim për mbrojtje ndërkombëtare, duhet së pari të plotësoni një intervistë paraprake që do të përfshijë shqyrtimin e nëse aplikimi juaj është i pranueshëm ose jo, ose mund të pranohet nga IPO-ja.

3.3 Si do të përcaktohet pranueshmëria e aplikimit tim?

3.3.1 Para se mund të bëni një aplikim për mbrojtje ndërkombëtare, si pjesë e intervistës suaj paraprake, duhet të bindni një oficer të mbrojtjes ndërkombëtare që aplikimi juaj është i pranueshëm.

- 3.3.2 Aplikimi juaj nuk do të jetë i pranueshëm (dhe nuk do të keni të drejtë të aplikoni për mbrojtje), nëse:
- (i) Një shtet tjetër anëtar i BE-së ju ka dhënë statusin e refugjatit ose mbrojtjes së përkohshme dhe/ose
 - (ii) një vend, i ndryshëm nga një shtet anëtar i BE-së
 - a. ju ka njohur si refugjat dhe mund të shfrytëzoni këtë mbrojtje, ose
 - b. gëzoni, në një formë tjetër, mbrojtje të mjaftueshme në atë vend, duke përfshirë edhe duke përfituar nga parimi i mosdëbimit dhe do të ripranoheni në atë vend.
- 3.3.3 Një oficer i mbrojtjes ndërkombëtare do të bëjë një rekomandim në lidhje me pranueshmërinë e aplikimit tuaj pas intervistës paraprake.
- 3.3.4 Nëse merrni një rekomandim nga një oficer i mbrojtjes ndërkombëtare që aplikimi juaj për mbrojtje ndërkombëtare është i papranueshëm, do të merrni një raport të shkruar me arsyet.
- 3.3.5 Ju keni të drejtë ta apeloni këtë rekomandim pranë IPAT-it brenda periudhës përkatëse ligjore. Informacione të mëtejshme në lidhje me apelimet gjenden në **seksionin 5. Vendimi i IPAT-it do të merret pa mbajtur një seancë dëgjimore.**
- 3.3.6 Në qoftë se oficeri i mbrojtjes ndërkombëtare rekomandon që aplikimi juaj është i papranueshëm dhe se rekomandimi është konfirmuar nga IPAT-i, Ministri duhet të vendosë që aplikimi juaj është i papranueshëm.
- 3.3.7 Nëse është konstatuar se aplikimi është i pranueshëm, nga IPO-ja ose IPAT-i, ai do të pranohet për hetim nga Ministri dhe për përcaktim nga ana e IPO-së.
- 3.4 Nëse unë kam marrë tashmë një vendim për një aplikim të mëparshëm për mbrojtje ndërkombëtare, a mund të bëj një tjetër aplikim (aplikimi i vijues)?**
- 3.4.1 Një person nuk mund të bëjë një aplikim të dytë ose tjetër (*aplikim vijues*) për mbrojtje ndërkombëtare pa pëlqimin e Ministrit.
- 3.4.2 Kërkesa për të marrë pëlqimin e Ministrit për të bërë një aplikim vijues për mbrojtje ndërkombëtare duhet të bëhet me shkrim te Ministri dhe do të konsiderohet nga një oficer i mbrojtjes ndërkombëtare.
- 3.4.3 Në mënyrë që të keni të drejtë për të bërë një aplikim vijues, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:
- (i) Që nga përcaktimi i aplikimit të mëparshëm për mbrojtje ndërkombëtare, kanë lindur elemente apo gjetje të reja ose janë paraqitur nga ju, të cilat e bëjnë atë që të ketë ndjeshëm më shumë shanse që ju do të kualifikoheni për mbrojtje ndërkombëtare,

dhe

keni qenë, pa fajin tuaj, të paaftë për t'i paraqitur këto elemente apo gjetje për qëllimet e aplikimit tuaj të mëparshëm,

ose

- (ii) Nëse aplikimi i mëparshëm është tërhequr, ose konsiderohet se është tërhequr, në kohën e tërheqjes ose tërheqjes së vlerësuar, keni qenë, pa fajin e tuaj, të paaftë për të ndjekur aplikimin tuaj të mëparshëm

3.4.4 Në qoftë se oficeri i mbrojtjes ndërkombëtare rekomandon që Ministri duhet t'ju jap pëlqimin për marrjen e një aplikimi vijues, Ministri do t'ju japë atë pëlqimi dhe pastaj ju mund ta bëni aplikimin.

Në qoftë se oficeri i mbrojtjes ndërkombëtare rekomandon që Ministri *nuk* do të japë pëlqimin e tij ose të saj që ju të bëni aplikimi vijues, do të merrni një raport të shkruar me arsyet.

3.4.5 Ju keni të drejtë për ta apeluar rekomandimin e fundit tek IPAT-i brenda periudhës përkatëse ligjore. Informacione të mëtejshme në lidhje me apelimet gjenden në **seksionin 5. Vendimi i IPAT-it do të merret pa mbajtur një seancë dëgjimore.** Nëse nuk apeloni, Ministri do t'ju refuzojë pëlqimin për të bërë një aplikim vijues.

3.4.6 Nëse jeni të suksesshëm në apelin tuaj, Ministri do t'ju japë pëlqimin për të bërë aplikim vijues. Nëse jeni të pasuksesshëm në apelin tek IPAT-i, Ministri do t'ju refuzojë pëlqimin për të bërë një aplikim vijues.

3.5 Çfarë është intervista paraprake?

3.5.1 Pasi keni përfunduar një intervistë paraprake, ndër të tjera, do t'ju bëhen disa pyetje të shkurtra në lidhje me

- (i) faktin nëse dëshironi të bëni një aplikim për mbrojtje ndërkombëtare dhe, nëse është kështu, bazat e përgjithshme në të cilat bazohet aplikimi,
- (ii) identitetin tuaj,
- (iii) kombësinë tuaj,
- (iv) vendin tuaj të origjinës/vendin e mëparshëm të banimit të përhershëm,
- (v) rrugën në të cilën erdhët në shtet (Irlandë), mjetet e transportit të përdorura dhe detajet e çdo personi që ju ka ndihmuar të udhëtonit në Irlandë,
- (vi) arsyet pse erdhët në Irlandë,
- (vii) baza ligjore për hyrjen ose praninë tuaj në shtet (Irlandë).

3.5.2 Ju do t'ju bëhen edhe disa pyetje për të përcaktuar nëse mund të pranoheni në procesin e mbrojtjes ndërkombëtare (**shih seksionet 3.3 dhe 3.4**).

3.5.3 Kjo intervistë paraprake, kur është e nevojshme dhe e mundshme, do të kryhet me ndihmën e një përkthyesi.

- 3.5.4 Një regjistrim i kësaj interviste paraprake do të mbahet nga oficeri që e kryen atë. Ajo do t'ju lexohet dhe ju do të keni mundësi për të bërë korrigjimet e regjistrimit, nëse është e nevojshme për ta bërë këtë korrigjim. Do t'ju kërkohet të nënshkruani një deklaratë për të konfirmuar se informacioni që keni dhënë është i saktë dhe se janë bërë të gjitha korrigjimet ose ndryshimet e nevojshme. Është shumë e rëndësishme që ta lexoni këtë deklaratë me kujdes për t'u siguruar që ajo përfshin të gjitha informacionet relevante që keni dhënë. Është përgjegjësia juaj për të siguruar që gjatë intervistës nuk jeni keqinterpretuar apo keqkuptuar. Pastaj do t'ju jepet një kopje e këtij regjistrimi të intervistë për të cilin u ra dakord.
- 3.5.5 Pas kësaj interviste paraprake, në qoftë se kërkesa juaj është konstatuar e pranueshme, do t'ju lejohet të bëni një aplikim për mbrojtje ndërkombëtare duke plotësuar një formular aplikimi.

3.6 A do të merren gjurmët e gishtërinjve dhe informacione të tjera biometrike?

- 3.6.1 IPO do të marrë informacionin tuaj biometrik. Kjo përfshin marrjen e shenjat të gishtave dhe fotografinë. Kjo bëhet për qëllimin e përcaktimit të identitetit tuaj dhe për të kontrolluar nëse janë bërë më parë aplikime për mbrojtje ndërkombëtare në një shtet nënshkruar të Rregullores së Dublinit (BE) (**shih seksionin 10**). Informacioni do të kontrollohet në bazat e tjera të të dhënave (përfshirë EUODAC dhe vizat) për të siguruar se Irlanda është vendi përgjegjës për të shqyrtuar aplikimin tuaj.

Shenjat e gishtave, një personi nën moshën 14 vjeçare, do t'i merren vetëm në prani të prindit apo të rriturit përgjegjës ose, sipas rastit, një personi të emëruar nga TUSLA - Agjencia për Fëmijët dhe Familjen për të bërë aplikimin dhe të përfaqësojë aplikantin gjatë procesit.

3.7 A do të marrë informacione më shkrim në lidhje me procesin e mbrojtjes ndërkombëtare?

- 3.7.1 Së bashku me këtë broshurë do t'ju jepet Aplikimi për Pyetësin e Mbrojtjes Ndërkombëtare, i cili duhet të plotësohet dhe t'i kthehet IPO-së. Ju duhet ta ktheni pyetësin brenda datës dhe kohës së specifikuar nga IPO-ja.

Nëse nuk do ta ktheni pyetësin tuaj në datën e përcaktuar, mund të konstatohet se keni dështuar në detyrën tuaj të bashkëpunimit për shqyrtimin e aplikimit tuaj. Në lidhje me këtë, shih seksionin 4.4 dhe seksionin 8.2.

- 3.7.2 Rekomandohet që të merrni këshillë ligjore para përfundimit të pyetësit tuaj.

3.8 Çfarë më nevojitet të kem me vete kur bëj aplikimin tim për mbrojtje ndërkombëtare?

- 3.8.1 Duhet t'i jepni IPO-së çdo dokument që keni në posedim tuaj kur bëni aplikimin. Këto dokumente përfshijnë

- **Pasaportën (Pasaportat)** - kjo përfshin pasaportën tuaj, dhe pasaportat e bashkëshortit tuaj dhe/ose çdo personi në ngarkim me ju në Irlandë (nëse zbatohet). Kjo ka si qëllim të ndihmojë IPO-në për të përcaktuar moshën, identitetin dhe kombësinë tuaj. Nëse keni përdorur një pasaportë të rreme për të gjithë ose një pjesë të udhëtimit tuaj në Irlandë, atëherë duhet ta sillni edhe këtë.
- **Të gjitha dokumentet e udhëtimit** - kjo përfshin biletat e udhëtimit dhe letrën e hipjes në bord, edhe nëse nuk janë lëshuar në emër të pasaportës ose dokumentit vendas të identitetit të përdorur për të udhëtuar.
- **Dokumente të tjera** - kjo përfshin karta identiteti, certifikata lindje/martese/dëftesa shkolle, karta anëtarësimit dhe të gjithë dokumentet e tjerë relevante për kërkesën tuaj.

3.8.2 Ju duhet t'i siguronit IPO-së **të gjithë dokumentacionin e disponueshëm** për të mbështetur aplikimin tuaj **sa më shpejt të jetë e mundur**. Këto duhet t'ia dorëzoni IPO-së, ose, nëse nuk jeni në gjendje ta bëni këtë kur bëni aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare, duhet t'i siguronit ato sa më shpejt të jetë e mundur para ose në intervistën tuaj të mbrojtjes ndërkombëtare. Nëse nuk jeni në gjendje të plotësoni të gjitha këto kërkesa, duhet t'i siguronit IPO-së çdo dokument tjetër brenda afatit kohor që mund t'ju caktohet në intervistën tuaj të mbrojtjes ndërkombëtare.

3.8.3 Në varësi të rrethanave të përfshira, mospagimi i dokumentacionit mund të konsiderohet si **moszbatim i detyrës suaj për të bashkëpunuar** me procesin e mbrojtjes ndërkombëtare. Shih **seksionin 4.4 dhe seksionin 8.2**.

3.9 Çfarë është Certifikata e Rezidencës së Përkohshme (TRC) dhe kur e marr atë?

3.9.1 Kur të bëni aplikimin tuaj për mbrojtje ndërkombëtare dhe nëse aplikimi konstatohet i pranueshëm, si pjesë e procesit të regjistrimit paraprak do të merrni një Certifikatë Rezidence të Përkohshme (TRC). TRC-ja është dëshmia se keni dorëzuar një aplikim për mbrojtje në Irlandë.

3.9.2 TRC-ja **nuk** është një kartë identiteti dhe nuk është dëshmi e identitetit tuaj, por kjo do të përmbajë të dhënat personale të dhëna në IPO, duke përfshirë emrin tuaj, datëlindjen dhe kombësinë, si dhe fotografinë tuaj.

3.9.3 TRC-ja, e cila mund të rinovohet, mbetet pronë e Ministrisë dhe duhet ta dorëzoni kur ju kërkohet nga Ministri. TRC-ja juaj bëhet e pavlefshme kur leja juaj për të hyrë dhe qëndruar në Shtet (Irlandë), si një aplikant mbrojtjes, nuk është më e vlefshme.

3.9.4 Lutemi, sigurohuni ta mbani TRC-në tuaj deri në datën ku tregohet se ju keni leje për të qenë në Shtet (Irlandë) për qëllimin e aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare.

3.10 Çfarë ndodh nëse jam person me aftësi të kufizuar ose kam nevoja të veçanta?

3.10.1 Ju lutem vini në dijeni IPO-në, sa më shpejt të jetë e mundur, në lidhje me çdo nevojë të veçantë apo kërkesat për intervistën tuaj. Gjithashtu, duhet të informoni IPO-në për çdo nevojë të veçantë në ditën që jeni duke bërë aplikimin tuaj. Kur është e mundur, IPO-ja do të përpiqet për t'ju përgjigjur nevojave të arsyeshme për të cilat na informoni.

3.11 A mund të aplikoj për mbrojtje ndërkombëtare nëse jam në arrest ose në paraburgim?

3.11.1 Ju mund të aplikoni për mbrojtje ndërkombëtare, edhe nëse jeni në paraburgim apo arrest në Shtet (Irlandë). Mund ta bëni një aplikim për mbrojtje vetëm me anë të Guvernatorit të institucionit ku jeni ndaluar. Duhet të njoftoni Zyrën e Guvernatorit menjëherë nëse dëshironi të bëni një aplikim për mbrojtje. Zyra e Guvernatorit do të bëjë rregullimet e nevojshme me IPO-në që aplikimi juaj të përpunohet.

3.11.2 IPO-ja do t'i japë përparësi shqyrtimit dhe përcaktimit të një aplikimi nga një person në paraburgim.

3.12 Në cilat rrethana mund të arrestohet një aplikues për mbrojtje ndërkombëtare?

3.12.1 Një oficer i emigracionit apo një anëtar i "Garda Síochána" mund ta arrestojë një aplikant pa urdhër, nëse dyshon, me arsye se kërkuesi:

- (i) përbën një kërcënim për sigurinë publike ose të rendit publik në Shtet (Irlandë),
- (ii) ka kryer një krim të rëndë jopolitik jashtë Shtetit (Irlandë),
- (iii) nuk ka bërë përpjekje të arsyeshme për të përcaktuar identitetin e tij ose të saj,
- (iv) ka ndërmend të largohet nga shteti (Irlandë) dhe, pa autoritetin e ligjshëm, të hyjë në një tjetër shtet,
- (v) ka vepruar apo ka për qëllim të veprojë në një mënyrë që do ta dëmtonte -
 - sistemin për dhënien e mbrojtjes ndërkombëtare për personat në Shtet (Irlandë), ose
 - çdo dispozitë në lidhje me Zonën e Përbashkët të Udhëtimit (shih seksionin 2.10), ose
- (vi) pa justifikim të arsyeshëm -
 - ka shkatërruar identitetin ose dokumentin e tij/saj të udhëtimit, ose
 - është ose ka qenë në posedim të një dokumenti identiteti të falsifikuar, të ndryshuar apo zëvendësuar.

3.12.2 Nëse jeni të arrestuar për ndonjë nga shkaqet e lartpërmendura, mund të dërgoheni në një vend të caktuar paraburgimi. Një person i ndaluar në këtë mënyrë, dërgohet para Gjykatës së Qarkut, sa më shpejt të jetë e mundur, e cila mund të dërgojë personin në paraburgim për një periudhë deri në 21 ditë, ose ta lirojë personin duke iu nënshtruar kushteve. Periudha e ndalimit mund të rinovohet herë pas here deri në 21 ditë në pritje të përcaktimit të aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare. Një person i ndaluar në bazë të këtyre dispozitave ka të drejtë që të konsultohet me një përfaqësues ligjor, dhe të marrë ndihmën e një përkthyesi për qëllimin e konsultimit me përfaqësuesin ligjor dhe për paraqitje para gjykatës.

3.13 Çfarë ndodh nëse kam nën ngarkim persona nën 18 vjeç?

3.13.1 Me kusht që ai ose ajo të mos jetë shtetas irlandez, një fëmijë i varur nën 18 vjeç do të konsiderohet për t'u përfshirë në aplikimin tuaj. Ky supozim vlen nëse fëmijë ishte i pranishëm ose jo në shtet (Irlandë) në momentin e bërjes së aplikimit tuaj.

3.13.2 Prandaj, në qoftë se bëni një aplikim për mbrojtje ndërkombëtare, do të konsiderohet se keni bërë një aplikim edhe në emër të fëmijës suaj të varur, i cili nuk është shtetas irlandez dhe

- (a) në kohën e bërjes së aplikimit, është i pranishëm në Shtet (Irlandë) dhe është nën 18 vjeç,
- (b) ka lindur në Shtet (Irlandë), ndërkohë që jeni një aplikant,
- (c) i cili është nën moshën 18 vjeç dhe hyn në Shtet (Irlandë), ndërkohë që jeni një aplikant.

3.12.3 Nëse po aplikoni për mbrojtje ndërkombëtare dhe keni fëmijë në ngarkim, duhet t'i sillni me vete në IPO, kur të bëni aplikimin tuaj.

3.13.4 E rëndësishme: Nëse fëmija juaj ka lindur pasi keni bërë një aplikim për mbrojtje ndërkombëtare, ose ndonjë nga personat në ngarkimin tuaj arrin më pas në Shtet (Irlandë), pasi kërkesa juaj është bërë, duhet ta sillni menjëherë fëmijën/fëmijët në IPO.

3.14 Ku mund të marr këshillë ligjore?

3.14.1 Keni të drejtë për të konsultuar një përfaqësues ligjor në lidhje me bërjen e aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare. Mund të përfitoni nga shërbimet e Bordit të Ndhmës Ligjore (LAB), e cila do të

- (i) ofrojë ndihmë ligjore dhe këshilla në mbështetje të aplikimit tuaj.
- (ii) këshillojë në lidhje me plotësimin e pyetësorit tuaj të mbrojtjes ndërkombëtare, duke përfshirë ndonjë arsye që ju mund të dëshironi që të paraqisni me qëllimin për t'i kërkuar Ministrit që ai duhet t'ju japë leje për të qëndruar në Shtet (Irlandë).

- (iii) t'ju asistojë në përgatitjen për intervistën tuaj të mbrojtjes ndërkombëtare dhe çdo përfaqësim me shkrim tek Ministri.
- (iv) në rastin e një rekomandimi negativ në aplikimin tuaj, të sigurojë përfaqësim për ju në çdo apel që mund të bëni pranë Gjykatës së Apelit për Mbrojtje Ndërkombëtare (IPAT).

3.14.2 Informacionet e kontaktit të LAB-it jepen në **shtojcën** bashkëngjitur këtij dokumenti.

3.14.3 Nëse nuk dëshironi t'i përdorni shërbimet e LAB-it, në mënyrë alternative, mund të kërkoni shërbimet e një përfaqësuesi ligjor privat me shpenzimet tuaja. Në qoftë se zgjidhni që të konsultoheni me një përfaqësues ligjor privat, duhet të siguroheni që ai ose ajo është i/e regjistruar si ndihmësavokat/e ose avokat/e praktike në shtet (Irlandë).

3.15 A mund ta tërheq aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare?

3.15.1 Zakonisht mund ta tërhiqni kërkesën tuaj për mbrojtje ndërkombëtare në çdo kohë para se raporti për aplikimin tuaj është përgatitur nga një oficer i mbrojtjes ndërkombëtare. Ju mund ta bëni këtë duke dërguar një njoftim për tërheqjen e kërkesës në IPO. Njoftimi duhet të përfshijë adresën më të përditësuar, numrin tuaj të referencës dhe nënshkrimin tuaj. Nëse keni fëmijë në ngarkim të përfshirë në aplikimin tuaj, duhet të përfshini të dhënat e tyre në njoftimin e tërheqjes.

3.15.2 Efekti i tërheqjes së aplikimit tuaj do të jetë se apeli në IPAT do të jetë i padisponueshëm dhe Ministri do të refuzojë t'ju japë një deklaratë të statusit të refugjatit ose të statusit të mbrojtjes së përkohshme. Megjithatë, lutemi vini re se Ministri nuk do të vazhdojë të marrë parasysh nëse duhet t'ju jepet ose leje për të qëndruar për arsye të tjera. Nëse nuk keni një bazë mbi të cilën të qëndroni në Shtet (Irlandë), ka të ngjarë të rrezikoheni nga një propozim për një urdhër dëbimi.

3.15.3 Para se të tërhiqni aplikimin tuaj për mbrojtje ndërkombëtare, duhet të kërkoni këshilla ligjore për t'u siguruar se i keni kuptuar plotësisht pasojat e vendimit tuaj.

Seksioni 4

Intervista dhe shqyrtimi

4.1 Çfarë mund të pres në intervistën e mbrojtjes ndërkombëtare?

- 4.1.1 Do të merrni informacione në lidhje me datën, kohën dhe vendin e intervistës suaj të mbrojtjes ndërkombëtare **me shkrim nga IPO-ja**. Intervista juaj do të kryhet në privat. Nëse ju keni kërkuar një oficer intervistues dhe/ose përkthyes mashkull apo ose, IPO-ja do të marrë masa për një gjë të tillë kur është e nevojshme dhe e mundur.
- 4.1.2 Intervista juaj është mundësia që keni për të folur ballë për ballë me IPO-në dhe për të dhënë një përshkrim të plotë mbi arsyen pse e keni lënë vendin tuaj të origjinës/vendit të mëparshëm të banimit të përhershëm dhe pse keni frikë për t'u kthyer atje. Është shumë e rëndësishme të merrni pjesë në intervistë, të cilën do ta bëjmë sa më të ndjeshme dhe të sigurt që të jetë e mundur. Është shumë e rëndësishme të jepni një përshkrim të plotë të asaj që ju ka ndodhur në mënyrë të sigurtë dhe kush jeni apo cilët janë personat prej të cilëve keni frikë, nëse ktheheni në vendin tuaj të origjinës/vendi e mëparshëm të banimit të përhershëm.
- 4.1.3 Ne do t'ju intervistojmë në një gjuhë që ju mund të supozohet se e kuptoni, brenda arsyeve, dhe në të cilën jeni në gjendje të komunikoni. Një procesverbal me shkrim i intervistës do të mbahet nga oficeri i mbrojtjes ndërkombëtare dhe do t'ju lexohet në intervale të rregullta në mënyrë që të mund të bëni korrigjime të mundshme apo të përfshini më shumë informacione. Do t'ju kërkohet të nënshkruani çdo faqe të procesverbalit të intervistës për të konfirmuar se informacioni i dhënë është i saktë.
- 4.1.4 Është shumë e rëndësishme që të siguroni çdo provë ose informacion që ju duhet për të mbështetur historinë tuaj në kohën e intervistës (ose më herët nëse është e mundur). Nëse keni dëshmi të tjera që dëshironi t'i paraqisni pas intervistës, duhet ta bëni këtë brenda afatit të deklaruar nga IPO-ja.
- 4.1.5 Ne do të marrim parasysh çdo informacion specifik gjinor dhe çdo dobësi që ju përmendni në aplikimin tuaj, ose gjatë procesit të shqyrtimi.
- 4.1.6 **Në intervistën tuaj të mbrojtjes nuk do t'ju bëhen pyetje të drejtpërdrejta në lidhje me çështjen që ka të bëjë me lejen e qëndrimit. Intervista do të fokusohet në aplikimin tuaj të mbrojtjes.** Megjithatë, në rast se këto çështje lindin (për shembull, rrethanat tuaja familjare), ata do të regjistrohen me shkrim nga ana e oficerit të mbrojtjes ndërkombëtare. Nëse IPO-ja rekomandon që nuk duhet t'ju jepet mbrojtje ndërkombëtare, do të bëhen konsiderata nëse duhet t'ju jepet leje për të qëndruar mbi baza të tjera, dhe çdo informacion relevant i dhënë gjatë procesit të aplikimit të mbrojtjes do të merret parasysh në atë moment.

4.2 A mund të sjell dikë që të më mbështesë në intervistën për mbrojtje ndërkombëtare?

- 4.2.1 Intervista juaj do të kryhet në privat. Përfaqësuesi juaj ligjor mund të marrë pjesë në intervistë. Nëse merrni këshilla ligjore nga Bordi i Ndihmës Ligjore, duhet të verifikoni me përfaqësuesin tuaj ligjor, nëse do të jetë në gjendje të marrë pjesë ose jo. Në përgjithësi, askush tjetër nuk do të jetë në gjendje të marrë pjesë, përveçse nëse jeni nën 18 vjeç kur duhet të marrë pjesë kujdestari juaj ose një përfaqësues nga TUSLA - Agjencia për Fëmijët dhe Familjet.
- 4.2.2 Personi i cili ju shoqëron nuk do të jetë në gjendje të përgjigjet për çdo pyetje për ju.
- 4.2.3 Nëse dëshironi të sillni një përfaqësues ligjor, ai ose ajo do të lejohet për të vëzhguar në intervistë. Përfaqësuesit juaj ligjor do t'i jepet një mundësi në fillim dhe në fund të intervistës për të shprehur ndonjë pikë që ata e konsiderojnë të nevojshme. Ata nuk do të jetë në gjendje t'i përgjigjen çdo pyetjeje për ju.

4.3 Çfarë ndodh nëse nuk mund të paraqitem në intervistë ose nuk paraqitem në intervistë?

- 4.3.1 Sepse e keni detyrë të bashkëpunoni në mënyrë aktive me procesin e shqyrtimit, intervista mund të shtyhet vetëm për shkaqe të shëndetit të keq apo shkaqe të tjera të **jashtëzakonshme**. Duhet ta informoni-n' IPO **sa më shpejt të jetë e mundur** nëse mendoni se mund të keni një problem për t'u paraqitur në intervistë. Pritet prej jush të siguronit dëshmi mjekësore të sëmundjes nga mjeku juaj (Mjeku i përgjithshëm ose konsulenti) në IPO para intervistës.
- 4.3.2 Nëse nuk merrni pjesë në një intervistë personale në datën dhe në kohën e caktuar dhe, brenda 3 ditëve pune nga ajo datë, nuk i jepni IPO-së një shpjegim të arsyeshëm, IPO-ja do të vazhdojë ta shqyrtojë aplikimin tuaj në bazë të informacionit që keni dorëzuar deri në atë pikë në procesin e mbrojtjes. Me fjalë të tjera, humbisi mundësinë për të shpjeguar çështjet në një intervistë dhe aplikimi do të shqyrtohet në bazë të pyetësorit dhe të gjitha dokumenteve që keni paraqitur para kohës së caktuar për intervistë.

4.4 A e kam për detyrë të bashkëpunoj me procesin e aplikimit dhe cilat janë pasojat nëse nuk e bëj këtë?

- 4.4.1 Është detyra juaj të bashkëpunoni në mënyrë aktive me shqyrtimin e aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare.
- 4.4.2 Detyra juaj për të bashkëpunuar ka një gamë të gjerë dhe përfshin nevojën
- (i) të thoni të vërtetën dhe të paraqisni, sa më shpejt që është e mundur, të gjithë informacionin e nevojshëm për të mbështetur aplikimin tuaj (kjo përfshin deklaratat dhe dokumentet në dispozicion në lidhje me elemente të rëndësishme të aplikimit tuaj), dhe

- (ii) për të bashkëpunuar në shqyrtimin e aplikimit tuaj dhe në përcaktimin e apelit.

4.4.3 Nga ju kërkohet gjithashtu që të veproni në përputhje me të gjitha detyrimet e tjera të Aktit të Mbrojtjes Ndërkombëtare 2015. Në lidhje me këtë, shih **seksionin 8**.

4.4.4 Nëse Ministri është i mendimit

- (i) se jeni duke dështuar në detyrën tuaj të bashkëpunimit në shqyrtimin e aplikimit tuaj, ose
- (ii) që keni shkelur detyrimin tuaj për të mos e lënë apo të mos përpiqeni ta lini shtetin (Irlandë) pa pëlqimin e ministrit, ose
- (iii) që keni shkelur detyrimin tuaj për t'ia informuar Ministrit adresën tuaj dhe çdo ndryshim të adresës, sa më shpejt të jetë e mundur, ose
- (iv) që keni shkelur detyrimin tuaj për të përmbushur një njoftim që ju kërkonte prej jush të:
 - banoni ose qëndroni në një zonë të caktuar apo vend në shtet (Irlandë)dhe
 - raportoni në intervale të caktuara te një oficer emigracioni, ose në një stacion të caktuar Garda Síochána,

Ministri do t'ju njoftojë me shkrim për këtë mendim dhe do t'ju ftojë, brenda 10 ditëve pune, të jepni vërejtjet tuaja në kthimin e përgjigjes. Do t'ju kërkohet të konfirmoni se dëshironi që të vazhdoni me aplikimin tuaj dhe do t'ju rikujtohet detyrën juaj e bashkëpunimit.

4.4.5 Nëse

- (a) nuk ktheni përgjigje,

ose, pas marrjes në konsideratë të përgjigjes suaj,

- (b) Ministri vendos që ju nuk po bashkëpunoni me procesin e mbrojtjes,

kërkesa juaj do të shqyrtohet në bazë të informacionit që keni paraqitur para asaj kohe.

4.5 Çfarë është procesi i shqyrtimit kryesor, përfshirë intervistën time personale?

4.5.1 IPO-ja do të hetojë aplikimin tuaj për mbrojtje ndërkombëtare për të përcaktuar:

- së pari, nëse keni të drejtë apo jo për statusin e refugjatit, dhe,
- nëse jo, nëse keni të drejtë apo jo për mbrojtje të përkohshme.

4.5.2 Normalisht, procesi do të kërkojë

- një intervistë personale,
- shqyrtimin e aplikimit tuaj, duke përfshirë të gjithë informacionin e dorëzuar nga ju në shkrim ose në intervistë dhe
- përgatitjen e një raporti në lidhje me rezultatet e shqyrtimit. Ky raport do të përfshijë gjetjet dhe rekomandime nëse keni të drejtë apo jo për njërin nga format e mbrojtjes ndërkombëtare.

Intervista personale

4.5.3 Qëllimi i intervistës personale është të përcaktojë detajet e plota të aplikimit tuaj për mbrojtje ndërkombëtare. Bashkëshortët/partnerët intervistohen normalisht veç e veç.

4.5.4 Në intervistë, ju duhet

- (i) shpjegoni qartë dhe saktë se pse jeni duke kërkuar mbrojtje ndërkombëtare,
- (ii) shpjegoni qartë dhe saktë se pse ju jeni duke kërkuar mbrojtje ndërkombëtare në lidhje me personat nën ngarkim, nëse ka,
